



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 29 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 31/ 01 / 2025

VENDIM

Nr.03, datë 31 /01/2025

PËR

PROBLEMATIKAT E KONSTATUARA NË DIGËN E BOVILLËS

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 31.01.2024 mori në shqyrtim Problematikat e konstatuara gjatë inspektimit të kryer në digën e Bovillës nga grupi i punës së KKDM dhe SKDM në muajin Janar 2025.

Gjatë inspektimit të kryer në digën e Bovillës u konstatua se **monitorimi i kësaj dige të madhe mjaft të rëndësishme nuk kryhet në përputhje me kërkesat e legjislacionit të mësipërm**. Prej shumë vitesh, në digë nuk është kryer ndonjë monitorim gjeodezik, sizmik, hidrogeologjik dhe gjeologjik me instrumenta. Instrumentat e Sistemeve të monitorimit të digës janë jasht funksionit. Ekipi i UKT që admnistron këtë digë nuk disponon të dhëna të monitorimit me instrumenta të digës që prej më se 10 vitesh..

Në digë dhe në zonën poshtë saj nuk ka asnjë sistem alarmi për rastet e emergjencave civile megjithëse, bazuar në legjislacionin në fuqi, kjo digë me lartësi 91 m dhe me rezervuar me volum uji prej më se 78 milion m³ konsiderohet vepër e rëndësishme së vecantë. Duke patur paraysh edhe faktin se poshtë kësaj dige banojnë më se 100 000 banorë që përfshihen në hartën e përmbytjeve për shkak të shfrytëzimit të kësaj dige si dhe legjislacionin për sigurinë e digave është emergjente instalimi i një sistemi alarmi bashkëkohor për sinjalizim në kohë reale të emergjencave civile.

Gjithahstu, gjatë kontrollit në terren u vu re se në anën e djathtë të digës, afro 500 m larg saj vërehet një carje e madhe e një masivi shkëmbor, problematika e të cilit është identifikuar prej vitesh nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar dhe UKT por deri me sot nuk është ndërmarre asnjë masë për identifikimin dhe monitorimin e madhësisë së kësaj carje ndër vite dhe eliminimin e rrezikshmerinë që mund të ketë për shfrytëzimin dhe sigurinë e digës.

Gjatë kontrollit në terren u konstatuan disa punime mbushje dhe betoni për një rrugë këmbësore turistike në zonën e shkarkuesit katastrofik të digës të cilat krijojnë probleme për funksionimin e shkarkuesit gjatë shfrytëzimit të digës si dhe për sigurinë e levizjes së njerëzve që nuk janë personel i UKT.

Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

VENDOSI:

1- Ti kërkohet UKT dhe Bashkisë Tiranë:

- **Të marrë masa urgjente për Furnizimin dhe vëndosjen e instrumentave të monitorimit të digës** të kërkuar në legjislacionin e mësipërm si dhe monitorimin me instrumenta të digës dhe përgatitjen e bazës së të dhënave të monitorimit të digës sipas Udhëzimeve dhe kërkesave të KKDM. Projekti dhe skemat e monitorimit duhet të miratohen në KKDM.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- **Të marrë masa urgjente për furnizimin dhe vëndosjen e një sistemi bashkëkohor të alarmit në digë dhe në zonën poshtë saj** me lajmërim në kohe reale në digë dhe në zonën poshtë saj, projekti i zbatimit për sistemin e Alarmit duhet të miratohet në KKDM.
- **Të pezullohen menjëherë punimet e rrugës këmbësore tek zona e shkarkuesit katastrofik dhe të kthehet zona në gjëndjen e përcaktuar në projektin origjinal.** UKT duhet të marrë masat e duhura për rritjen e sigurisë së levizjes së personelit në digë dhe në tunelin e shërbimit për tek sistemet e marrjes së ujit dhe të shkarkuesit katastrofik duke shqyrtuar edhe masat e mbrojtjes nga rënia e gureve në hyrje dhe në dalje të këtij tuneli.
- **Të përditësoj Rregulloren e Shfrytëzimit, monitorimit dhe sigurisë së digës** sipas kërkesave të nenit 29 të VKM së mësipërme dhe udhëzimeve të dhëna në Vendimin e KKDM Nr. 31, datë 27.12.2022,
- **Të kryej matjet e volumeve aktuale të ujit në rezervuar dhe të hartoj kurbat e volumeve** dhe të sipërfaqes së ujit për rezervuarin deri në nivelin maksimal të ujit të parashikuar në projekt sipas kërkesave të nenit 30 të VKM së mësipërme.
- **Të përditësoj planin e gadishmërisë në rastet e emergjencave civile për shkak të prishjes së mundshme të digës apo prurjeve maksimale që mund të vijnë në rezervuar.** Ky plan duhet të jetë i shoqëruar me hartat e përmbytjeve sipas kërkesave të nenit 35 të VKM së mësipërme.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë Vendim sipas legjislacionin në fuqi. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI